



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut

Nr 2557/ Prot



Fushë-Arrëz, më 26.08.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 22, datë 07/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin **“Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028”**

Analiza ligjore Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të radhës me datë, zbatim të nenit 55, 64, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit 9669 date 18.12.2006 "Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare", i ndryshuar, VKM nr.334 dt17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", Ligjit nr 18/2017 "Per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes", neni 36 i Ligjit nr.121, date 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.150 datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e Llogaritjes Fondeve për Financimin e Shërbimeve Të Kujdesit Shoqëror", pika 11, shkresën nr.2171, datë 15.04.2019 Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, Drejtoria e Finances dhe e Buxhetit, Sektori i ndihmës ekonomike dhe shërbimit social me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

Situata aktuale e funksionit: Dokumenti në vijim është i organizuar në dy pjesë:

Pjesa e parë përmban Raportin e Vlerësimit të Nevojave, i cili jep të dhëna të detajuara mbi situatën egzistuese në këndvështrimin e (i) organizimit, strukturave dhe kapaciteteve të stafit lokal të shërbimeve të kujdesit shoqëror, (ii) individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë

Fushë-Arrëz, (iii) shërbimeve egzistuese në territor. Kjo pjesë përmban rekomandime specifike për ndryshimin e situatës së ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Fushë-Arrëz mbi bazën edhe të konsultimeve të kryera me aktorët publik e jo publik në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Pjesa e Dytë përmban Planin Social të Bashkisë Fushë-Arrëz, i hartuar mbi bazën e nevojave për shërbime të identifikuara të individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë, kuadrin ligjor, strategjitë dhe standartet kombëtare specifike, si dhe politikat lokale të zhvillimit.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha shtresave të varfra në të gjithë territorin të bashkisë

A është objekt i konsultimit publik: Është objekt konsultimi public dhe konsultimi me publikun është mbajtur me datë 21 Gusht 2025.

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 26/08/2025, shqyrtoi projekt “Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Pavlin Qafa  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit

dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 2557



Fushë-Arrëz, më 26.07.2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion mbi Projektvendimin për **Planin Vendor Social 2025-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz**, që do t'i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqerisjen vendore", i ndryshuar; Rregullores për Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut në mbledhjen e datës 26.08.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Franc Doda, Pavlin Qafa dhe Tereze Dema, mori në shqyrtim projektvendimin për miratimin e Planit Vendor Social 2025-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë për Çështjet Sociale, thotë se:

Plani Social Vendor përfaqëson një dokument strategjik të rëndësishëm për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Ai është rezultat i një procesi të kujdesshëm planifikimi, konsultimi dhe analizimi të gjendjes sociale në territor, duke pasur në qendër qytetarin dhe mirëqenien e tij. Ky plan nuk është thjesht një dokument administrativ, por një udhërrëfyes politikash, masash dhe ndërhyrjesh konkrete që synojnë mbështetjen e shtresave më të ndjeshme të popullsisë dhe garantimin e barazisë sociale.

Hartimi i Planit Social Vendor bazohet mbi kuadrin ligjor kombëtar për shërbimet sociale, mbi strategjitë kombëtare të mbrojtjes sociale dhe mbi parimet themelore të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe solidaritetit. Ai përfaqëson një kontratë sociale midis pushtetit vendor dhe komunitetit, duke përcaktuar qartë detyrimet, objektivat dhe prioritetet për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për qeverisjen vendore", Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri", përgatitja dhe zbatimi i Planit Social është detyrim ligjor i njësive të vetëqeverisjes vendore.

Planit Social në vijim është i organizuar në dy pjesë:

Pjesa e parë përmban Raportin e Vlerësimit të Nevojave, i cili jep të dhëna të detajuara mbi situatën ekzistuese në këndvështrimin e:

- (i) organizimit, strukturave dhe kapaciteteve të stafit lokal të shërbimeve të kujdesit shoqëror,
- (ii) individëve dhe grupeve në nevojë në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz,
- (iii) shërbimeve ekzistuese në territor.

Kjo pjesë përmban rekomandime specifike për ndryshimin e situatës së ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Fushë-Arrëz, mbi bazën edhe të konsultimeve të kryera me aktorët publikë e jo publikë.

Pjesa e dytë përmban Planin Social të Bashkisë Fushë-Arrëz, i hartuar mbi bazën e nevojave për shërbime të identifikuara të individëve dhe grupeve në nevojë, kuadrin ligjor, strategjitë dhe standardet kombëtare specifike, si dhe politikat lokale të zhvillimit.

Metodologjia ku ne jemi mbështetur është pjesë e metodologjisë së ndjekur nga Shërbimi Social Kombëtar për politika lokale dhe synon të japë një panoramë të plotë nëpërmjet:

- Të dhënave demografike bazë,
- Profilit dhe karakteristikave të përdoruesve të shërbimit,
- Shërbimeve ekzistuese në territorin e Bashkisë ose që përfshijnë edhe bashkitë fqinje,
- Shpërndarjes së shërbimeve në territor,
- Financimit të shërbimeve aktuale,
- Të dhënave mbi strukturat e ngritura në Bashki dhe njësi administrative në përputhje me ligjin.

Nevoja për një plan social vendor buron nga realitetet dhe sfidat konkrete me të cilat përballlet komuniteti. Çdo njësi vendore ka karakteristikat e saj demografike, ekonomike dhe sociale, dhe për rrjedhojë, nevojat sociale ndryshojnë nga një territor në tjetrin.

Hartimi i Planit Social Vendor është i domosdoshëm për arsye kryesore:

1. Identifikimi i nevojave reale të qytetarëve.
2. Përcaktimi i prioriteteve.
3. Koordinimi ndërinstitutional dhe partneriteti.
4. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe garantimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Objektivat kryesore të Planit Social Vendor janë:

- Sigurimi i mbrojtjes dhe kujdesit social për shtresat në nevojë.
- Zhvillimi i shërbimeve komunitare.
- Fuqizimi i qytetarëve.
- Promovimi i barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale.
- Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve.

Prioritetet kryesore të Planit Social janë:

1. Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve.
2. Mbështetja për të moshuarit.
3. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara.
4. Familjet në vështirësi ekonomike.
5. Zhvillimi i shërbimeve sociale komunitare.

Plani përballlet me sfida të tilla si:

- Burimet e kufizuara financiare.
- Kapacitetet njerëzore.
- Ndërgjegjësimi i shoqërisë.
- Monitorimi dhe transparenca.

Rekomandime:

- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm monitorimi.
- Sigurimi i fondeve alternative.
- Rritja e ndërgjegjësimit publik.

Plani Social Vendor është një instrument thelbësor për garantimin e mbrojtjes sociale dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ai i jep një drejtim të qartë veprimeve të bashkisë, duke vendosur standarde, objektiva dhe masa konkrete.

Ky plan nuk është i mbyllur dhe statik, por një dokument i gjallë, që pasurohet vazhdimisht me mendimet, sugjerimet dhe nevojat e qytetarëve. Vetëm përmes pjesëmarrjes së komunitetit dhe bashkëpunimit të aktorëve të ndryshëm, plani social mund të kthehet në një mjet efektiv për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë sonë.

Pa asnjë diskutim anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur duke e dërguar atë për miratim në mbledhjen e datës 27.08.2025 të Këshillit Bashkiak, duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

PER KOMISIONIN

Franc Doda



Pavlin Qafa

